

V E N D I M
Nr.351, datë 30.6.1993

**PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR PASUNIVERSITAR DHE KLASIFIKIMIN E
PUNONJËSVE PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË**

Me propozimin e Komitetit të Shkencës e të Teknologjisë dhe të Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 Sistemi i kualifikimit shkencor pasuniversitar (më tej KSHP) synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të kryer veprimtari kërkimore-shkencore e pedagogjike me rezultate të krahasueshme e në nivelin e kohës, dhënien e gradës shkencore sipas kriterëve të caktuara në këtë vendim dhe klasifikimin e tyre.

1.2 Kryerja e KSHP nënkupton përfundimin e doktoratës dhe paraprkishtë si rregull marrjen e diplomës së studimeve të thelluara pasuniversitare (DSTHP).

1.3 Institucionet që kanë të drejtë të drejtojnë KSHP dhe të japin DSTHP e gradën shkencore, si dhe të bëjnë propozime për klasifikimin pedagogjik e atë shkencor, caktohen nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor (KKSH).

2. Diploma e studimeve të thelluara pasuniversitare

2.1 Për marrjen e DSTHP organizohen shkolla pasuniversitare (SHPU) pranë shkollave të larta, të përcaktuara sipas pikës 1.3.

Qëllimi themelor i SHPU është përgatitja e thellë teorike e praktike e kandidatit në fushën që do të lëvrojë, përvetësimi i elementeve të punës kërkimore-shkencore dhe përgatitja e një mikroteze diplome.

2.2 Propozimi për hapjen e SHPU bëhet nga departamenti ose dega e shkollës së lartë, që siguron nivelin dhe kushtet e përshtatshme për funksionimin e saj. Propozimi dërgohet nga rektorati përkatës, së bashku me mendimin e tij në KKSH, i cili jep vendimin përfundimtar.

Në këtë propozim duhet të paraqiten: plani mësimor i SHPU, programet e lëndëve teorike, seminareve praktike, seancave laboratorike etj., ekipi pedagogjiko-shkencor që do të zhvillojë e kryejë vlerësimin dhe rrugët e financimit. Në ekip mund të përfshihen edhe punonjës të jashtëm me kualifikim të lartë pedagogjik e shkencor, të miratuar nga dekani i fakultetit përkatës.

Në planin mësimor të SHPU duhet të parashikohet edhe dhënia e provimit pasuniversitar të një gjuhe të huaj (anglisht, frengjisht, rusisht, gjermanisht, italisht etj.) sipas profilin.

2.3 Afati i SHPU, si rregull, është 1 vit. Në raste të veçanta, me miratimin e KKSH, ai mund të jetë deri në 2 vjet.

2.4 Në SHPU pranohen kandidatë shqiptarë e të huaj që kanë mbaruar shkollën e lartë brenda ose jashtë vendit me rezultate shumë të mira dhe janë nën moshën 32 vjeç. Për raste të veçanta përjashtimet bëhen nga KKSH.

2.5 Kërkesa për pranim në SHPU paraqitet nga të interesuarit pranë departamentit përkatës. Ajo përmban:

2.5.1 diplomën e shkollës së lartë, së bashku me dëftesën e notave;

2.5.2 fushën e studimeve, rekomandimin nga institucioni përkatës dhe specialitetin e dëshiruar;

2.5.3 dokumente të tjera eventuale për veprimtarinë e kandidatit, si certifikata provimesh, botime etj.;

2.5.4 deklaratën vetjake ose vërtetimin për përballimin e shpenzimeve të SHPU të caktuara për çdo kandidat sipas pikës 6.2.

Përgjigjja për pranimin ose mospranimin e motivuar të kërkesës jepet nga dekani i fakultetit përkatës.

2.6 DSTHP u jepet kandidatëve që likuidojnë me sukses provimet dhe detyrimet e tjera sipas planit mësimor dhe paraqitin një tezë diplome, që vlerësohet pozitivisht nga udhëheqësi shkencor i kandidatit, i caktuar nga SHPU. Kandidati mbrohet përpara një komisioni të posaçëm dhe në diplomën

që i jepet, shënohen fusha e specialiteti përkatës.

2.7 KKSJ nxjerr udhëzime të veçanta për ngritjen e komisioneve, marrjen në provime dhe vlerësimin minimal të pranuar për njohjen e mbarimit me sukses të SHPU.

3. Doktorata

3.1 Doktorata organizohet pranë shkollave të larta dhe instituteve dhe qendrave kërkimore të përcaktuara sipas pikës 1.3.

3.2 Qëllimi i doktoratës është përgatitja e specialistëve të kualifikuar për punë kërkimore shkencore, si rregull, mbi bazën e formimit të fituar në SHPU nëpërmjet hartimit të një disertacioni me trajtime origjinale të problemit të shqyrtuar.

3.3 Disertacioni i doktoratës kryhet, si rregull, nën drejtimin e udhëheqësit shkencor me kualifikim të lartë pedagogjiko-shkencor (së paku asistent profesor ose mjeshtër kërkimesh). Afati i përgatitjes dhe i mbrojtjes së disertacionit është 3-5 vjet.

3.4 Tematika e disertacioneve të doktoratës propozohet në Komitetin e Shkencës dhe të Teknologjisë nga institucionet shtetërore e private të interesuara, mbi bazën e programeve për kërkim e zhvillim të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, në bashkëpunim me shkollat e larta dhe institutet e përcaktuara në pikën 1.3, harton projektplanin e pranimit për çdo vit dhe tematikën përkatëse. Miratimi për temën bëhet nga KKSJ.

3.5 Pranimi bëhet mbi bazën e konkursit. Procedurat e pranimit e të regjistrimit do të jenë sipas rregullores dhe udhëzimeve të veçanta të KKSJ.

3.6 Disertacioni i doktoratës duhet të ketë nivel të lartë shkencor, të pasqyrojë punën e pavarur kërkimore-shkencore të disertantit, kontributin e tij në zgjidhjen e problemeve që e çojnë përpara shkencën, teknologjinë, ekonominë e kulturën tonë, si dhe të mbështetet në rezultate origjinale të tij, të krahasueshme këto me rezultatet shkencore të kohës në vende të tjera.

3.7 Mbrojtja e disertacionit të doktoratës bëhet përpara jurisë, që ngrihet për çdo disertacion pranë qendrave të përcaktuara në pikën 1.3. Leja për mbrojtjen e disertacionit jepet nga drejtuesi i qendrës së mësipërme mbi bazën e kërkesës së disertantit, të mbështetur me shkrim nga udhëheqësi shkencor. Për secilin rast miratimi për mbrojtjen dhe përbërjen e jurisë jepet nga KKSJ. Si rregull, juria duhet të përbëhet nga 5 punonjës me kualifikim të lartë, 3 nga të cilët të jashtëm për qendrën ku është përgatitur disertacioni.

3.8 Pas miratimit të disertacionit të doktoratës nga juria, disertanti merr gradën "Doktor" dhe diplomën përkatëse, që lëshohet nga drejtuesi i institucionit. Pranë KKSJ bëhet regjistrimi i saj.

4. Klasifikimi i punonjësve pedagogjikë e kërkimorë

4.1 Klasifikimi pedagogjiko-shkencor i personelit pedagogjik dhe atij kërkimor bëhet për vendet që ka çdo njësi (katedra, sektori etj.), në përputhje me nivelin e kualifikimit, veprimtarinë e zhvilluar, leksionet e dhëna, punimet e kryera, artikujt, tekstet e monografitë e botuara, pjesëmarrjen në seminare, kolokuiume e konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, drejtimin e veprimtarive pedagogjike në shkollat e larta në lëndë të caktuara ose drejtimin e kërkimit në fusha të ndryshme të shkencës.

4.2 Punonjësit pedagogjikë të universiteteve e të shkollave të tjera të larta, në varësi nga vendi e roli që kanë në veprimtarinë e mësimdhënies dhe nga kontributi i tyre personal shkencor, klasifikohen:

4.2.1 PROFESOR emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta me përvojë të gjatë mësimdhënieje, që është autor tekstesh origjinale universitare, hartues programesh për lëndë a cikle speciale, autor artikujsh shkencorë e monografish, që ka drejtuar katedra ose ka qenë titullar lëndësh a grupe-lëndësh, ka udhëhequr diploma a disertacione dhe zotëron disa gjuhë të huaja, për dy nga të cilat ka dëshminë përkatëse.

4.2.2 ASISTENT PROFESOR emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta me përvojë të gjatë mësimdhënieje, që është autor tekstesh universitare, autor artikujsh e monografish, që ka qenë titullar lëndësh, ka udhëhequr diploma e disertacione dhe që zotëronn dy gjuhë të huaja, për të cilat ka dëshminë përkatëse.

4.2.3 PEDAGOG është punonjësi pedagogjik me gradën "Doktor i shkencave", që jep leksione sipas programeve dhe teksteve të autorëve të tjerë, është autor artikujsh shkencorë, ka udhëhequr diploma universitare dhe zotëron një gjuhë të huaj, për të cilën ka certifikatën përkatëse.

4.2.4 ASISTENT është kuadri i lartë i atashuar për punë ndihmëse pranë katedrës ose mësimdhënësve të tjerë. Kur përgatitet për pedagog, ndjek SHPU dhe doktoratën.

4.3 Punonjësit kërkimorë të instituteve dhe qendrave kërkimore-shkencore dhe ata pranë shkollave të larta, në varësi nga niveli shkencor dhe kontributi personal, si dhe vendi që kanë në veprimtarinë kërkimore-shkencore, klasifikohen në:

4.3.1 DREJTUES KËRKIMESH emërtohet punonjësi kërkimor me përvojë të gjatë, i cili ka drejtuar kërkimet në fushën e vet, është specialist në disa disiplina të ngushta, është autor artikujsh e monografish, si dhe botimesh në gjuhë të huaj, ka qenë pjesëmarrës në konferenca shkencore brenda e jashtë vendit dhe zotëron disa gjuhë të huaja, për dy nga të cilat ka dëshminë përkatëse.

4.3.2 MJESHTËR KËRKIMESH emërtohet punonjësi kërkimor me përvojë, specialist në një fushë kërkimesh, autor artikujsh e monografish, që është pjesëmarrës në konferenca shkencore, dhe zotëron dy gjuhë të huaja, për të cilat ka certifikatën përkatëse.

4.3.3 PUNONJËS KËRKIMOR emërtohet punonjësi shkencor me gradën "Doktor i shkencave", i ngarkuar me plan të rregullt për kërkime të caktuara shkencore në një fushë dhe që ka dhënë prova me artikuj shkencorë.

4.3.4 ASISTENT emërtohet kuadri i lartë ndihmës i atashuar pranë sektorit ose kërkuesve të tjerë. Kur përgatitet për punonjës kërkimorë, ndjek SHPU dhe doktoratën.

4.4 Vendet për të gjitha shkallët e mësipërme të veprimtarive pedagogjike-shkencore propozohen nga njësitë bazë (katedra, sektori etj.), shqyrtohen nga këshillat shkencore të fakulteteve e instituteve dhe i përcillen për miratimin përfundimtar KKSH. Kjo procedurë ndiqet edhe për hapjen e vendeve të reja, në varësi nga shtimi i veprimtarisë pedagogjike dhe asaj kërkimore.

4.5 Veprimtaria pedagogjike ose kërkimore e kandidatëve që konkurrojnë për të fituar vende sipas klasifikimeve të mësipërme, shqyrtohet publikisht në mbledhje të katedrave (sektorëve) e të këshillave shkencore të fakulteteve (instituteve). Miratimin përfundimtar e japin shkollat e larta dhe institutet kërkimore të përcaktuara në pikën 1.3.

4.6 Për të gjitha vendet e punës në shkollat e larta dhe institutet kërkimore konkurrohet çdo 4 vjet. Nëse për vendet vakante nuk ka persona që i kanë cilësitë e kërkuara, pranohen fitues me nivel më të ulët, por pas dy vjetësh për ato vende shpallet konkurs i ri.

4.7 Emërtimet sipas klasifikimeve të fituara të mësipërme mbahen përgjithnjë, me përjashtim të rasteve kur hiqen me vendim publik të KKSH. Pagesa e parashikuar për to përfitohet deri në afatin e konkurrimit të ri.

4.8 Punonjësit pedagogjiko-shkencorë me tituj e grada shkencore sipas vlerësimeve në fuqi gjer më sot paraqesin në qendrat e tyre të punës kërkesat për emërtimet e reja, të cilat shqyrtohen sipas këtij vendimi dhe udhëzimeve të posaçme të KKSH.

Gradat shkencore, të mbrojtura sipas rregullave në fuqi gjer më sot, barazohen të gjitha me gradën e re e të vetme "Doktor i shkencave". Titujt dhe gradat e mëparshme pas riklasifikimit bëhen të pavlefshme.

4.9 Punonjësit pedagogjiko-shkencorë që për veprimtarinë e tyre të derisotme riklasifikohen sipas emërtesave të reja pedagogjiko-shkencore, i mbajnë këto, pavarësisht nga vendi që do të kenë në njësitë pedagogjiko-shkencore, për të cilin edhe do të paguhet.

4.10 Personat që kanë emërtimet PROFESOR, ASISTENT PROFESOR, DREJTUES KËRKIMESH e MJESHTËR KËRKIMESH, sipas vendeve të punës që kryejnë, pas moshës 55 vjeç nuk konkurrojnë më, por i ruajnë ato deri në fund të veprimtarisë.

4.11 Për veprimtari shumë të shquar mësimore-shkencore, të ushtruar për një kohë shumë të gjatë, jepet edhe titulli i nderit "Doctor Honoris Causa". Ky titull jepet nga KKSH me propozim të shkollës së lartë.

5. Komisioni i Kualifikimit Shkencor (KKSH)

5.1. Komisioni i Kualifikimit Shkencor krijohet pranë Këshillit të Ministrave. Përbërja e tij miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në KKSH bëjnë pjesë punonjës të dalluar me kualifikim të lartë nga fusha të ndryshme të veprimtarisë kërkimore-shkencore, si dhe zyrtarë të lartë me gradë shkencore që mbulojnë fushat përkatëse.

Për funksionimin e KKSH caktohet një sekretari me një punonjës, fondi i pagës i të cilit përballohet nga ai i miratuar.

5.2 KKSH ka këto detyra e të drejta:

5.2.1 Miraton hapjen e SHPU, kur gjykon se janë plotësuar kërkesat e caktuara.

5.2.2 Përcakton institucionet që kanë të drejtë të hapin SHPU, të japin DSTHP e gradën shkencore dhe të bëjnë propozim për klasifikimin e personelit pedagogjik e shkencor.

5.2.3 Shqyrton propozimet për vendet dhe për emërtimet pedagogjiko-shkencore për çdo shkallë, si dhe jep për to miratimin përfundimtar.

5.2.4 Miraton juritë e mbrojtjes së disertacioneve.

5.2.5 Regjistron diplomat e doktoratës.

5.2.6 Harton dhe miraton rregulloren e funksionimit të KKSH.

5.2.7 Harton dhe miraton rregulloret për veprimtaritë në këto fusha dhe nxjerr udhëzime metodike për interpretimin e zbatimin e këtij vendimi dhe të rregulloreve.

6. Dispozita financiare

6.1 Shpenzimet për ngritjen dhe funksionimin e SHPU përballohen nga buxheti i shkollave të larta, pranë të cilave ngrihen.

6.2 Pasuniversitarët që dërgohen në SHPU ose për disertacion nga shkollat e larta, institucionet kërkimore dhe qendrat e tjera të punës, gjatë kohës së SHPU-së dhe përgatitjes së disertacionit trajtohen me bursë, që është 40 për qind më e lartë se bursa e studentit. Ata kanë të drejtë të banojnë në Qytetin e Studentëve ose në konviktet e tjera të shkollave të larta dhe përfitojnë po ato lehtësi që u jepen studentëve.

6.3 Pedagogëve dhe punonjësve të tjerë që japin mësim në SHPU, ngarkesa u llogaritet me koeficient konvertimi: 4 për leksionet, 3 për seminarët, 2 për laboratorët.

6.4 Pjesëmarrja në juritë për mbrojtjen e disertacioneve dhe në mbledhjet e KKSH shërblehet jashtë ngarkesës mësimore të pedagogëve ose jashtë kohës së punës të punonjësve të tjerë, në masën e caktuar nga KKSH.

6.5 Për udhëheqjen e disertantit, gjatë kohës së përgatitjes së disertacionit, udhëheqësit shkencor i njihet një ngarkesë prej 120 orësh mësimore në vit.

6.6 Bursat për studentë pasuniversitarë miratohen nga Ministria e Arsimit, Akademia e Shkencave dhe institucione të tjera të interesuara. Bursat mund t'u jepen vetëm atyre që nuk e kalojnë moshën 32 vjeç.

6.7 Shpenzimet e tjera (për labore, ekspedita etj.) për kandidatët që ndjekin SHPU drejtpërdrejt pas mbarimit të shkollës së lartë, përballohen nga Ministria e Arsimit, kurse për kandidatët e tjerë përballohen në masën 30 për qind nga Ministria e Arsimit dhe 70 për qind nga qendra e punës së kandidatëve, kur ata janë në punë, ose nga vetë kandidatët, kur ata nuk janë në marrëdhënie pune.

6.8 Shpenzimet për mbrojtjen e disertacioneve dhe për shqyrtimin e dhënies së titujve shkencorë janë në ngarkim të shkollave të larta dhe instituteve shkencore përkatëse.

6.9 Kur kandidati pa arsye nuk kryen detyrat e kualifikimit shkencor, detyrohet të kthejë shpenzimet që janë bërë për të deri në atë kohë.

7. Dispozita kalimtare dhe të fundit

7.1 Kandidatët e regjistruar në shkallën e parë të kualifikimit pasuniversitar mund të vazhdojnë punën sipas rregullave të këtij vendimi dhe udhëzimeve të KKSH.

7.2 Të regjistruarve në SHPU u njihen si të shlyera detyrimet e parashikuara në planin mësimor të shkollës me vendim të posaçëm të ekipit drejtues të saj, që ligjëson ekuivalentimin e tyre me certifikata provimesh ose dokumente të tjera të paraqitura nga të interesuarit.

7.3 Mbrojtja e disertacioneve përpara jurive si rregull bëhet e hapur, përveç rasteve kur, për natyrë të veçantë të problemeve të trajtuara (konfidenciale, sekrete etj.), drejtuesi i institucionit autorizon mbrojtjen me publik të kufizuar.

7.4 Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.379, datë 8.9.1987, "Për kualifikimin shkencor pasuniversitar për marrjen e gradave dhe të titujve shkencorë", dhe nr.180, datë 9.5.1992 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.379, datë 8.8.1987", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi